



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 384 Prot

Tiranë, më 24/01 2023

URDHËR

Nr. 37, datë 24/01/2023

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT  
TË INTERESAVE NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES  
SOCIALE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të nëpunësve publik”, i ndryshuar si dhe ligjit Nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar,

URDHËROJ :

1. Miratimin e rregullores për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Zbatimin e mënjëhershëm të kësaj rregulloreje nga të gjithë punonjësit e aparatit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
3. Urdhëri nr. 779, datë 13.12.2019 “Për miratimin e rregullores për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, shfuqizohet.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

## RREGULLORE

### PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

## KREU I

### RREGULLA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Baza ligjore

Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesit në MSHMS, bazoitet në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar dhe në ligjin nr.9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar.

#### Neni 2 Përkufizime

1. "Zyrtar" është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike në MSHMS.
2. "Eprorët e zyrtarëve" në MSHMS, sipas hierarkisë, brenda institucionit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë:
  - Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
  - Sekretari i Përgjithshëm
  - Drejtori i Kabinetit
  - Drejtorët e Përgjithshëm
  - Drejtor Drejtoria
  - "Institucion epror" për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është Këshilli i Ministrave.
1. "Person i lidhur me një zyrtar të MSHMS-së" është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interes, pasurore ose vetjake jo pasurore, me zyrtarin sipas përcaktimit të pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
2. "Parim i proporcionalitetit" (sipas nenit 46 te ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar), është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave të një zyrtari të MSHMS-së, me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë dhe/ose kompetencat e tij, aq më të shumta janë kufizimet e interesave vetjake.

#### Neni 3 Fusha e zbatimit

- Rregullorja përcakton norma të detyrueshme për t'u zbatuar nga:
1. çdo zyrtar i MSHMS-së, që ndodhet në pozicione, ka përgjegjësi, kryen detyra ose ushtron kompetenca të llojeve konkrete, të përcaktuara shprehëmisht në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në ligjin nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar,

2. çdo zyrtar i MSHMS-së, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për akte dhe kontrata administrative;
3. çdo zyrtar i MSHMS-së kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për kontrata, që krijojnë marrëdhënie juridiko-civile, me palë këto subjekte;
4. personat e lidhur në masën dhe mënyrën e përcaktuar në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në nenin 37 të Kodit të Procedurave Administrative.

#### **Neni 4 Çastet paraprake të vendimmarrjes**

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje:
  - a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilët vendoset përbajtja përfundimtare e aktit;
  - b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, të cilat janë thelbësish të rëndësishme dhe përcaktuese për përbajtjen përfundimtare të aktit, që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara si më poshtë:
    - i) hartimin e projekt aktit nga zyrtari ose zyrtarët dhe dorëzimin organit apo zyrtarit kompetent për vendimmarrje;
    - ii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, për këtë projekt akt nga zyrtarë të tjera, brenda apo jashtë institucionit;
    - iii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, nga çdo zyrtar si pasojë e kërkësave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projekt akt;
    - iv) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, të çdo zyrtari me kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin;
    - v) përfshirjen e çdo dokumenti paraprak, ndërmjetës dhe/ose shoqërues të një vendimmarrjeje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, të ardhurat, shpenzimet, strategjitet, burimet njerëzore, funksionet, detyrat e përgjegjësitet administrative pa praninë e të cilëve nuk do të vendosej dhe mbështetet përbajtja përfundimtare e projekt aktit ose projekt-kontratës në tërësinë e tyre;
    - vi) çdo rast tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të fushës së veprimtarisë së MSHMS-së.

#### **Neni 5 Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt**

1. Një zyrtar i MSHMS-së ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas nenit 4 të rregullores, përcaktojnë përbajtjen e aktit.
2. Si kompetencë thelbësore e përcaktuese e një zyrtari për një akt, përfshihet, në secilin nga çastet paraprake të mësipërme të vendimmarrjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarrjen që buron nga:
  - a) roli zyrtar urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi në përgatitjen, negocimin, propozimin,

- këshillimin, miratimin, administrimin, kontrollin ose ekzekutimin e një akti apo kontrate;
- b) zotërimi i informacionit, që lidhet kryesisht me të dhëna sensitive dhe të dhëna për subjekte tregtare ose të dhëna të tjera personale;
  - c) çdo shkak tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të funksionit e të veprimitarëve të zyrtarëve të MSHMS-së.
3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave të mësipërme të kësaj rregulloreje, përbën çast paraprak të vendimmarrjes apo kompetencë thelbësore e përcaktuese për një akt ose kontratë, çdo rast i vlerësuar si i tillë nga autoriteti përgjegjës i MSHMS, i emëruar si i tillë nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe nga zyrtarët-eprorë në MSHMS-së.
  4. Në secilin prej çasteve të mësipërme, zyrtari, pjesëmarrës në vendimmarrje, me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, është i detyruar të deklarojë, në zbatim të pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, nëse ka një interes privat që mund të shkaktojë rënien në konflikt interesit të çfarëdo lloji.
  5. Në të njëjtat raste, eprori ose institucioni epror mund t'i kërkojë zyrtarit të deklarojë rast pas rasti interesat private në zbatim të nenit 7, pikës 2 të ligjit 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar.
  6. Kur vlerësohet se ka rrezik për rënien në konflikt interesit të zyrtarit, veprohet sipas nenit 37 të ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005.

#### **Neni 6 Interesat private**

1. Interesat private të një zyrtari janë ato interesa që parashikon neni 5 i ligjit 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, e konkretisht:
  - a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;
  - b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;
  - c) dhurata, premtimi, favore, trajtime preferenciale;
  - ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhënieve me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;
  - d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
  - dh) marrëdhënie:
  - i) familjare apo të bashkëjetësës;
  - ii) të komunitetit;
  - iii) etnike;
  - iv) fetare;
  - v) të njoitura të miqësisë apo të armiqësisë;
  - c) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendura në shkronjat e mësipërme të këtij neni.
2. Kufizimet e interesave private, të përcaktuara shprehimisht ne ligjin 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.
3. Nëse në ligjin 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesit, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet

shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për kriteret e përcaktura në ligjin 9367 datë 07.4.2005, i ndryshuar, dhe anasjelltas.

4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo lloj interesit privat i zyrtarit nga ata të përcaktuar në nenin 5 të ligjit 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, çdo lidhje apo gërshtim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesit ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesit, shfaqet një gjendje me konflik interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4 të nenit 3 të ligjit te lartpërmendur.

## **KREU II**

### **PROCEDURAT DHE MJETET PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KONFLIKTEVE RAST PAS RASTI TË INTERESAVE**

#### **Sekzioni 1**

##### **Identifikimi dhe regjistrimi i interesave në kushtet e konflikteve rast për rast të interesave**

###### **Neni 7**

###### **Deklarimi rast për rast i interesave privatë të zyrtarit**

1. Çdo zyrtar i MSHMS-së, sipas përcaktimeve të bëra në këtë rregulllore në ushtrimin e kompetencave apo në kryerjen e detyrave të tij publike në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim detyrohet të bëj vetëdeklarim paraprak rast pas rasti të ekzistencës së interesit të tij privatë që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesit.
2. Deklarimi rast për rast i interesave privatë bëhet çdo herë nga zyrtarët kur kjo kërcohët nga eprori ose nga institucioni epror.
3. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërcohët dhe bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.
4. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkësë bëhet me shkrim, kur zyrtari ose punonjësi përfshihet në një vendimmarrje për një akt dhe/ose për subjekte të deklarimit periodik të interesave privatë në MSHMS-së.
5. Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e Autoritetit Përgjegjës të institucionit të tij në bazë të vetëdeklarimit të zyrtarit të MSHMS-së, si dhe në bazë të të dhënave që ka, merr masat e nevojshme që të shmangë emërimin e një zyrtari në pozicione, në të cilat mund të lindin osc ka konflikte interesash. Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale merr masa që zyrtarit të mos t'i ngarkohen detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti të mundshëm interesash dhe në rast të kundërt merr masa për largimin e zyrtarit nga detyra. (Bashkëlidhur gjeni aneks 1 “Deklarim rast pas rasti i interesave private të zyrtarit në ushtrimin e funksioneve publike” dhe aneks 2 “Deklarim për konfliktin e vazhdueshëm të interesave private nga zyrtari në ushtrimin e funksionit publik”).

###### **Neni 8**

###### **Identifikimi i interesave privatë të zyrtarit nga persona të tretë**

1. Ofrimi i informacionit, për interesat privatë të zyrtarit në MSHMS-së është:
  - a) detyrë e çdo zyrtari që ka dijeni;

- b) e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi, që ka dijeni dhe që ka një interes në përgjithësi, e që përputhet me qëllimin e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
2. Burime të tjera informacioni për interesat private të një zyrtari dhe punonjësi të MSHMS-së mund të jenë edhe ato burime të parashikuara në nenin 9 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

**Neni 9**  
**Lëshimi i autorizimit nga zyrtari i MSHMS-së**

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale vë në dispozicion të zyrtarëve të saj modelin e autorizimit, në formë e në përbajtje, që këta duhet të lëshojnë.
2. Në rastin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Zëvëndësministrave autorizimi vihet në dispozicion, të Këshillit të Ministrave.

**Neni 10**  
**Autoritetet Përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave**

1. Autoriteti qëndror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave.
2. Autoritet/struktura përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji në MSHMS-së janë:
  - Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
  - Sekretari i Përgjithshëm
  - Drejtori i Kabinetit
  - Drejtoreti e Përgjithshëm
  - Drejtoreti e Drejtive
  - Autoriteti Përgjegjës i caktuar me Urdhër Ministri
  - "Institucion epror" për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është Këshilli i Ministrave.

**Neni 11**  
**Detyrat e Autoritetit Përgjegjës**

1. Autoriteti Përgjegjës kryen detyrat e mëposhtme:
  - a) mbledh dhe dokumenton interesat private të zyrtarëve;
  - b) shpérndan dhe mbledh autorizimet e detyrueshme për t'u lëshuar nga zyrtarët sipas nenit 10 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe përçaktimeve të kësaj rregulloreje;
  - c) krijon regjistrin përkatës dhe mban regjistrimet rast për rast të konfliktit të interesit;
  - d) bazuar në regjistrimin dhe vlerësimin e interesave private të zyrtarëve, u sugjeron atyre dhe/ose eprorëve të tyre, çështjet dhe momentet kur zyrtarët, dhe/ose eprorët e tyre duhet të tregohen të kujdeshshëm për parandalimin e:
    - i. konfliktit rast për rast të interesit (faktik, në dukje dhe të mundshëm);
    - ii. konfliktit të vazhdueshëm të interesit;
  - e) kryen me autorizim të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale verifikimin e interesave të deklaruara apo të padeklaruara të zyrtarëve dhe punonjësve të këtij institucioni,

- duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që i jep ligji, dhe informon për këtë, sipas rastit Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- f) mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin përvendosjen e gjabave në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, në kuptim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar;
- g) informon, këshillon zyrtarët në lidhje me këtë ligj, me të drejtat e detyrimet e tyre dhe me parandalimin sa më të mirë të konfliktit të interesave;
- h) merr masa për të siguruar aksesin dhe informimin e publikut në të dhënat personale të zyrtarëve dhe me dokumentet e tjera zyrtare që lidhen me konfliktin e interesit duke u bashkërenduar me strukturën përgjegjëse për të drejtën e informimit dhe mbrojtjes së të dhënavë personale;
- i) Në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse për çështjet gjyqësore:
- i. marrin masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në konflikt interesit, zyrtarëve përgjegjës, si dhe mbështesin MSHMS-në në ndërmarrjen e hapave ligjore për dëmshpérblimin e palëve të treta të dëmtuara dhe kalimin e barrës së dëmshpérblimit te zyrtarët përgjegjës;
  - ii. orientojnë, vlerësojnë, kontrollojnë apo krycijnë hetim administrativ në lidhje me konfliktin e interesit të zyrtarëve të MSHMS-së, në përputhje me rregulloren dhe urdhurat e miratuara nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
  - iii. shtrojnë çështje dhe kërkojnë këshilla nga Inspektorati i Përgjithshëm i Deklarimit dhe Konfliktit të Interesave, për zbatimin e këtij ligji, si dhe përmirësimë në ligje të tjera kur kjo ka të bëjë me çështjen e konfliktit të interesave;
- j) bën me dije zyrtarët dhe punonjësit e MSHMS-së për çdo këshillë apo udhëzim të ILDKPKI-së;
- k) ndjek e zbaton detyra të tjera që i ngarkohen sipas kësaj rregulloreje.

### **Neni 12** **Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave**

1. Për regjistimet e konflikteve rast për rast të interesave të zyrtarëve të MSHMS së, krijohet regjistri me të njëjtin emër.
2. Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave administrohet nga autoriteti përgjegjës i MSHMS-së .

### **Neni 13** **Regjistimet rast për rast të konflikteve të interesit**

Autoriteti përgjegjës për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistron identitetin e zyrtarit të MSHMS-së, interesat privatë të tij, shkak për konflikt interesit, thelbin e konfliktit, palët e interesuara, burimin e të dhënavë, mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre, si dhe vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, ose nga gjykata.



## Sekzioni 2

### Identifikimi dhe regjistrimi periodik i interesave privatë

#### Neni 14

##### Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave privatë

1. Deklarimi i interesave private periodike të zyrtarëve të MSHMS-së bëhet në përpunje kërkuese të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
2. Zyrtarët e MSHMS-së, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarim të interesave private periodike janë:
  - a) Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
  - b) Zëvendësministrat e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
  - c) Drejtori i Kabinetit;
  - d) Këshilltarët e MSHMS-së;
  - e) Sekretari i Përgjithshëm në MSHMS;
  - f) Drejtorët e Përgjithshëm në MSHMS;
  - g) Drejtorët e Drejtive të MSHMS-së;
3. Gjithashtu, në zbatim të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, mbartin detyrim për deklarim të interesave privatë periodike bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë të zyrtarëve të MSHMS-së, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, edhe kur këta të fundit nuk janë në të njëjtën gjendje familjare me zyrtarin.
4. Çdo zyrtar i MSHMS-së, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, në rast largimi nga funksioni dhe në rast se nuk është më subjekt i deklarimit të interesave private periodike në MSHMS, ose kur kalon në një pozicion që nuk mbart detyrimin për deklarim, është i detyruar, që brenda 15 ditëve nga data e largimit nga funksioni, të plotësojë dokumentin zyrtar “Deklaratë pas largimit nga funksioni”. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës nuk mund të bëjnë dorëzimin e librezës së punës, të librezës së kontributeve shoqërore, të çdo dokumenti tjeter, si dhe pagimin e pagës së fundit dhe/ose shpërblimeve që mund t’i takojnë zyrtarin, në rast se ky i fundit nuk plotëson këtë detyrim ligjor.

#### Neni 15

##### Mbrojtja për dhënien e informacioneve

1. Çdo shtetas, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padeklaruara nga zyrtarët e MSHMS-së, përfiton, mbrojtje të veçantë administrative, si më poshtë:
  - a) zyrtari i MSHMS-së, për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi shtetasin informues (qoftë ky dhe subjekt i MSHMS-së), dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit;
  - b) kur marrja e masës ndaj shtetasit që informon përcaktohet nga një shkak tjetër ligjor, ajo merret vetëm nga një zyrtar tjetër i MSHMS-së, që qëndron në marrëdhënie varësie vertikale mbi zyrtarin, për të cilin është dhënë informacioni.

2. Nga parashikimi i pikës 1/b të këtij nenit bën përjashtim rasti kur marrja e masës administrative bëhet në kushtet kur konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm i zyrtarit të MSHMS-së është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
- a) kur zyrtari i MSHMS-së është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve;
  - b) kur vëtëpërjashtimi i zyrtarit është i pamundur, sepse është e pamundur delegimi i kompetencave të tij tek një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës;
  - c) kur vendimet e zyrtarit të MSHMS-së, sipas rregullimeve me ligj, nuk i nënshtrohen miratimit, revokimit ose shfuqizimit nga një institucion e pror;
  - d) kur nuk është i mundur transferimi i interesit privat, për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare etj.);
  - e) kur nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, zyrtari i MSHMS-së të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni. Në një rast të tillë, vendimet e këtij zyrtari i nënshtrohen një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga eprori apo institucion i epror të ngarkuar me ligj për të kryer kontrollin e këtyre vendimeve. Vendimi dhe rezultatet e kontrollit bëhen kurdoherë publike.

#### Neni 16

#### Kufizimi i interesave privatë për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta

1. Ministri dhe Zëvendësministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes:
  - a) nuk mund të jenë drejtues ose anëtarë të organeve drejtuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale dhe çdo organizate tjetër, përjashtuar organizatat politike dhe shtetërore, si dhe në rastet kur një pozicion i tillë diktohet për shkak të funksionit;
  - b) nuk mund të ushtrojnë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, si dhe profesionistë tregtarë, avokatisë, noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave të përcaktuara në shkronjën "a" të këtij neni, si dhe nuk mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër;
  - c) nuk mund të zoterojnë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj.
2. Zyrtarët e tjera të përcaktuara në pikat e nenit të kësaj rregulloreje:
  - a) nuk mund të jenë drejtues në organizatat fitimprurëse;
  - b) nuk mund të jenë anëtarë në organet drejtuese të një shoqërie tregtare ose në një organizatë jo fitimprurëse, kur:
    - i. këta ushtrojnë veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksimonit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar me akte të nxjerra nga ai;
    - ii. ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, me akte të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këto shoqëri ose organizata apo mbi shoqëri ose organizata të tjera që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me shoqërinë në fjalë, përjashtuar rastet kur ky pozicion në shoqëri ose organizatë vjen për shkak të funksionit dhë/ose të statusit;
  - c) nuk mund të ushtrojnë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e:
    - i. personit fizik tregtar;
    - ii. ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme;

iii.profesioneve të lira:

- a.të avokatisë;
- b.të noterisë;
- c.të ekspertit të licencuar
- d.të konsulentit të licencuar;
- e.të agjentit a të përfaqësuesit të organizatave, fitimprurëse;

- c) nuk mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjeter;
- d) mund të zotërojnë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, me përjashtim të rastit kur shoqëria ushtron veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksonit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitme ose kosto mbi këto apo mbi shoqëri të tjera, që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me shoqërinë në fjalë, rast në të cilin zyrtari mund të zotërojë aksione ose pjesë në kapital vetëm, në përputhje me kushtet e përcaktuara në shkronjën "c" të nenit 27 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005.

#### Neni 17

#### Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale

1. Është e ndaluar që një zyrtar i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale apo i institucioneve të varësisë të kërkojë, të pranojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, për familjen, të afërm, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesit të çdo lloji, ose që ndikon ose duket sikur ndikon në paanshmërinë e kryerjes së detyrës a është ose duket sikur është shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.
  - a) "Dhurata", sipas kësaj rregulloreje ka të njëjtin kuptim të përcaktuar në ligjin nr.9367, datë 07.4.2005 dhe në VKM-në nr.714, datë 22.10.2004;
  - b) Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të këtij neni, dhuratat, të cilat i ofrohen zyrtarit si pasojë e lidhjeve farefisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rastin kur është e qartë se dhurata nuk ka asnje lidhje me pozicionin dhe cilësinë si nëpunës i administratës publike, të personit, që merr dhuratën.
2. Zyrtari nuk duhet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një zyrtar të një niveli më të lartë apo të afërm të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga zyrtarë të një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.
3. Rregullat e mësipërme nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme apo kur janë të ftuar punonjës ose kolegë të tjera, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e zyrtarit.
4. Pranimi dhe vlerësimi i dhuratave bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr.9367, datë 07.4.2005 dhe në VKM-në nr.714, datë 22.10.2004.
5. Nëasnje rast zyrtari i MSHMS-së apo i institucioneve të varësisë nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.
6. Përjashtohen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsy protokollare.

## Neni 18

### Prania dhe kufizimi i interesave privatë të personave të lidhur me zyrtarin

- 1) Person i lidhur me zyrtarin e MSHMS-së, për kufizimet e interesave privatë të zyrtarëve, të përcaktuar në këtë rregullore janë përkatësish:
  - 2) bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/ja;
  - 3) çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim.
  - 4) Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin e MSHMS-së, të përcaktuara në këtë rregullore, zbatohen edhe për personat e lidhur me të, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.
  - 5) Përsa i përket kufijve të zotërimit të aksioneve ose të pjesëve në kapital, për zyrtarin e MSHMS-së dhe personin e lidhur me të, zbatohen drejtpërdrejtë parashikimet e nenit 24, pikat 4 e 5 dhe nenit 35, pikat 2 e 3, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
  - 6) Personi i lidhur me zyrtarin e MSHMS-së, nuk mund të ushtrojë veprimitari si person fizik tregtar ose ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, nëse veprimitaria përpunhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit të MSHMS-së dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte individuale apo normative të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këtë person fizik apo mbi shoqëri tregtare e persona të tjera fizikë, që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me personin e lidhur. Kjo pikë nuk zbatohet kur plotësohet kushti i mëposhtëm:
    - a) veprimitaria dhe/ose disa veprimitari tregtare së bashku të një personi të lidhur krijojnë një të ardhur të përgjithshme bruto vjetore, që nuk tejkalon kufirin e parashikuar nga ligji.

## Neni 19

### Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave për zyrtarët/ punonjësit e MSHMS-së bëhen sipas kreut IV të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

## Neni 20

### Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës

Asnjëra nga dispozitat e kësaj rregullore nuk mund të interpretohet sikur i jep zyrtarëve të MSHMS-së, të drejta që të ndërmarrin ndonjë veprimitari ose të kryejnë ndonjë akt që synon cënimin e parashikimeve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në këtë rregullore.

Në mungesë të parashikimeve të veçanta në këtë rregullore, zbatohen drejtpërdrejtë dispozitat e përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

## Neni 21

### Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.
2. Rregullorja e mëparshme dhc aktet që lidhen me të shfuqizohen.

## Aneksi nr.1

### **D E K L A R I M RAST PAS RASTI I INTERESAVE PRIVATE TË ZYRTARIT NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE**

**Kush mbart detyrimin për deklarim rast për rast të interesave private:**

Të gjithë zyrtarët e përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në rregulloren e brendshme të institucionit.

**Llojet e deklarimit:**

- 1- Vetdeklarim paraprak, rast për rast të ekzistencës së interesave private, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesit
- 2- Deklarim rast për rast të interesave private të një zyrtari kur kërkohet nga eprori ose institucioni epror.

**Të dhëna personale:**

Emri – Atësia – Mbiemri – Funksioni – Institucioni

---

**Lloji i deklarimit:** (vendos X në kutizën për llojin e deklarimit)

- Me kërkesë të \_\_\_\_\_  
 Vetdeklarim

Vërtetoj se deklarimet e bëra në vijim nga unë janë të plota, të vërteta, të sakta dhe mbaj përgjegjësi ligjore përvitetësinë e tyre.

- 1- Përshkrimi i hollësishëm i interesave private që bëhen shkak për një konflikt interesit:

---

2- Përmbytja e kufizimit ligjor në ushtrimin e funksioneve publike që bëhet shkak për një konflikt interesit:

---

- 3- Mënyra e zgjidhjes së konfliktit të interesave:

---

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshtakimi** \_\_\_\_\_

## Aneks nr.2

### **DEKLARIM PËR KONFLIKTIN E VAZHDUESHËM TË INTERESAVE PRIVATE NGA ZYRTARI NË USHTRIMIN E FUNKSIONIT PUBLIK**

**Mbartin detyrimin për deklarim të konfliktit të vazhdueshëm të interesave private:**

Të gjithë zyrtarët e përcaktuar në nenin 4 të Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndyshuar si dhe në rregulloren e brendshme të institucionit publik.

Llojet e deklarimit:

- 1- Vetdeklarim para fillimit të detyrës, të ekzistencës së interesave private, të cilat bëhen shkak për lindjen e konfliktit të vazhdueshëm të interesave.
- 2- Deklarim i interesave private të një zyrtari kur kërkohet nga eprori ose institucioni epror, për shkak të funksionit.

**Të dhëna personale:**

Emri – Atësia – Mbiemri – Funksioni – Institucioni

---

Lloji i deklarimit: (vendos X në kutizën për llojin e deklarimit)

- Vetdeklarim  
 Me kërkësë

Vërtetoj se deklarimet e bëra në vijim nga unë janë të plota, të vërteta, të sakta dhe mbaj përgjegjësi ligjore për vertetësinë e tyre.

1- Përshkrimi i hollësishëm i interesave private që bëhen shkak për një konflikt interesit:

---

---

2- Përmbytja e kufizimit ligjor në ushtrimin e funksioneve publike që bëhet shkak për një konflikt interesit:

---

---

3- Mënyra e zgjidhjes së konfliktit të interesave:

---

---

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

---